



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Nr.1155/_Prot.

Tiranë, më 08.07.2021

V E N D I M

Nr. 81, datë 08.07.2021

PËR

AUDITIMIN E USHTRUAR NË AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS, (ISH DREJTORIA PËRGJITHSHME E ALUIZNI-T SI DHE ISH- ZYRËN QENDRORE TË RPP) “MBI AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË NË DREJTORINË E ASHK” PËR PERIUDHËN NGA 01.05.2019 DERI NË 31.12.2020.

Nga auditimi i ushtruar në Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, (ish Drejtoria Përgjithshme e ALUIZNI-t si dhe ish- Zyrën Qendrore të RPP) rezultoi që, veprimtaria e subjektit të audituar, Agjencia Shtetërore e Kadastrës ka filluar në maj të vitit 2019 përmes ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën”, me detyrë të hartojë programe dhe miratojë urdhra e udhëzime për funksionimin, zhvillimin, përmirësimin dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve kadastrale dhe të aktivitetit në zbatim të legjislacionit për çështjet e pronësisë, në kryerjen e procedurave të shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave për legalizim si dhe procedurat e lëshimit të certifikatave të pronësisë dhe pasqyrimi i drejtë i pronës në regjistrat hipotekorë, që për periudhën objekt i këtij auditimi nuk ka qenë plotësisht efektive, rrjedhojë e mangësive në hartimin e zbatimit e ligjshmërisë si dhe në hartimin e dokumentacionit tekniko ligjor.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga grupi i auditimit të Departamentit të Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Drejtorisë së Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë, si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr.154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

V E N D O S A

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Mbi auditimin Financiar dhe Përputhshmërisë në Drejtorinë e ASHK” të ushtruar në Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, (ish Drejtoria Përgjithshme e ALUIZNI-t si dhe ish- Zyrën Qendrore të RPP), sipas programit të auditimit nr.1155/1, datë 11.01.2021, miratuar nga Kryetari i KLSH, për veprimtarinë në Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, (ish Drejtoria Përgjithshme e ALUIZNI-t si dhe ish- Zyrën Qendrore të RPP) në periudhën 01.05.2019 deri në 31.12.2020.

II. Të miratoj, rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

PËR AUDITIMIN FINANCIAR

OPINIONI I AUDITUESIT:

Opinion mbi pasqyrat financiare (I pamodifikuar me theksim të çështjes)

Ne audituam pasqyrat financiare të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, më datë 31.12.2019 të cilat përbëhen nga Bilanci, Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve, Pasqyra e Fluksit të Arkës, dhe Pasqyra e Lëvizjes së Kapitalit si dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë pasqyrat.

Në opinionin tonë, veprimet përgjatë raportimit financiar dhe transaksionet e kryera janë në përputhje me ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, si dhe me ligjet dhe rregullat përkatëse të financave publike. Për përmirësimin e mëtejshëm të gjendjes janë adresuar disa çështje të cilat paraqiten te paragrafi “*Theksimi i Çështjes*”.

Baza për opinionin mbi pasqyrat financiare

Ne e kemi kryer auditimin financiar në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI-s), Manuali i Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 64, datë 22.06.2020, si edhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “*Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 27, datë 20.04.2008, të Kryetarit të KLSH-së.

Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e **opinionit të pamodifikuar të auditimit me theksim të çështjes**¹.

Theksojmë nevojën e marrjes së masave nga ana e drejtimit e më pas në linjë hierarkike nga subjekti Agjencia Shtetërore e Kadastrës, sa i takon:

-Evidentimit të plotë dhe të saktë në evidencën kontabël dhe në Pasqyrat Financiare të vitit 2020, të vlerës së aktiveve afatgjata jomateriale “*toka troje terren*”, duke kontabilizuar dhe paraqitur në vlerën e drejtë të Aktiveve Afatgjata Jo Materiale.

-Të marrë masa në përputhje me legjislacionin në fuqi për saktësimin dhe rregullshmërinë e dokumentacionit për dy ndërtimet e paligjshme në pronën e saj dhe kryerjen e veprimeve të sistemit në kartelën e pasurisë, me qëllim paraqitjen e saktë dhe të drejtë të Aktiveve Afatgjata Jo Materiale.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjet nën auditim:

Stafi menaxherial i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara.

Përgjegjësia e Audituesve të KLSH-së:

Përgjegjësia e auditimit është të shprehë një opinion mbi pasqyrat financiare bazuar në rezultatet e auditimit të kryer, për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare janë pa gabime materiale. Audituesit e KLSH-së nëpërmjet auditimit të realizuar në këtë institucion krijuan bindjet, të cilat do të shprehen në opinionin e auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e ndërtimit të

¹ **OPINIONI I PAMODIFIKUAR me theksim të çështjes:** Një opinion i pamodifikuar me theksim çështje, jepet kur audituesi arrin në konkluzionin se për të gjitha aspektet materiale, pasqyrat financiare paraqesin një pamjen të vërtetë dhe të drejtë si dhe pasqyrat janë përgatitur në përputhje me bazën ligjore në fuqi për raportimin financiar. Theksimi i referohet një çështjeje të paraqitur ose shpalosur në mënyrë të duhur në pasqyrat financiare e cila, sipas gjykimit të audituesit, ka një rëndësi thelbësore për përdoruesin në mënyrë që të arrijnë të kuptojnë pasqyrat financiare. (ISSAI 1706.5)

pasqyrave financiare, raportimit financiar (*kriteret e auditimit financiar*) dhe shkallës së zbatueshmërisë nga subjekti, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (*kriteret e auditimit të përputhshmërisë*), ku veprimet janë kryer në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi (*kriteret*), dhe që gabimet apo parregullsitë e vërejtura, nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë jo materiale dhe jo të përhapura.

Objektivi ynë lidhet me dhënien e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të MB, me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara, administrative si dhe mbi përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve administrative të institucionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH, kanë aplikuar gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.

PËR AUDITIMIN E PËRPUTHSHMËRISË

Opinion mbi përputhshmërinë: (I pamodifikuar me theksim të çështjes)

Ne kemi audituar përputhshmërinë e veprimitarisë së Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, me Ligjin nr. 111/2018 “Për Kadastrën”; Ligjin 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”;

Në opinionin tonë, bazuar në punën e kryer të auditimit ka rezultuar se aktiviteti i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, është në përputhje në të gjitha aspektet materiale me Ligjet nr. 111/2018 “Për Kadastrën”; dhe nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.

Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin e përputhshmërisë në mbështetje me ligjin nr.154/2014, miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” në përputhje me (ISSAI 4100)² Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, Manuali i Auditimit Përputhshmërisë, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 66, datë 23.06.2020. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 27, datë 20.04.2008, të Kryetarit të KLSH-së.

Ne besojmë se evidencat e auditimit janë të mjaftueshme dhe krijojnë bazën e arsyeshme për dhënien e opinionit i pamodifikuar (me theksim të çështjes). Dhënien e opinionit i pamodifikuar (**me theksim të çështjes**) e mbështesim në konkluzionet e mëposhtme të arritura në përfundim të procesit të auditimit për marrjen e masave në zgjidhjen e çështjeve:

- Me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të ASHK nr. 1355, datë 12/05/2020 ka filluar procesi i regjistrimit fillestar për 8 zonat kadastrale të vijës bregdetare Vlorë-Sarandë, ky proces do të kryhet nga Projekti “Përmirësim/përditësim dhe regjistrim fillestar”. Në zbatim të këtij urdhri, punonjësit me kontratë janë angazhuar njëkohësisht për të dy proceset e regjistrimit, pa përfunduar më parë plotësisht projektin e iniciuar që në vitin 2016. Krahas këtij konstatimi, vihet re se në asnjë rast ASHK nuk ka punësuar numrin e plotë të punonjësve të nevojshëm sipas miratimit prej 382 punonjës, por ka punuar mesatarisht me rreth 60% të punonjësve të nevojshëm.

- Nga analiza e strukturës së institucionit dhe punonjësve me kontratë të ASHK-së konstatohet se shqetësues mbetet fakti i numrit shumë të lartë të punonjësve me kontratë të përkohshme për një periudhë të pacaktuar.

² ISSAI 4100 - Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi behet veçmas me auditimin e pasqyrave financiare.

- Në hartimin e planeve vjetorë të auditimit nga Drejtoria e Auditit të Brendshëm nuk janë parashikuar auditimi i rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme veprime në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” Neni 6 pika c, ç; Neni 12 pika d, si dhe me Manualin e Auditimit miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016. pika 4.1.13 “Ndjekja e rekomandimeve”.

Në raportet e veprimtarisë vjetore nuk arsyetohet shkresërisht mos realizimi i planit të auditimit si dhe shmangiet nga ky plan veprime në kundërshtim me ligjin 114/2015 Neni 14 “Përgjegjësitë e drejtuesit të njësive të auditimit të brendshëm” si dhe me Manualin e Auditimit.

- Nga Sektori i Kontrollit Tekniko Ligjor dhe Cilësisë së Shërbimit në kryerjen e kontrole pranë drejtorive dhe zyrave vendore, u konstatua se: Në 6 raste për një shkelje të konstatuar dhe të dokumentuar, janë marrë të dy masat si administrative, ashtu dhe disiplinore. duke vepruar në kundërshtim me referencën ligjore të referuar në çdo shkelje, pikës 2, neni 64 të ligjit 111/2018 “Për Kadastrën”.

- Deri në momentin e auditimit, në zbatim të Ligjit 111/2018 “Për Kadastrën” rezultojnë që 5 akte janë hartuar dhe dërguar/do të dërgohen me tepër vonesë dhe jashtë afatit të përcaktuar

Deri në momentin e auditimit, në zbatim të Ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” rezultojnë që janë 7 aktet ende të pa përcjella për shqyrtim që janë jashtë afatit të përcaktuar.

- Për periudhën Maj 2019 - 31/12/2020, Sektori i Marrëdhënieve me Publikun, Transparencës dhe Antikorrupsionit ka trajtuar 1111 praktika nga 1921 praktika të ardhura; nuk ka një dokumentacion për mos trajtimin e mbi 40 % të ankesave apo një delegim të tyre sipas kompetencave ligjore, personave përgjegjës; për çështjet e ankimuar me problematika që duhet të zgjidhen nga Drejtorive Vendore sipas detyrimeve ligjore në asnjë rast nuk ka një analizë apo nxjerrje përgjegjësie për Drejtoritë Vendore apo dhe për persona përgjegjës.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës:

Drejtimi i ASHK është përgjegjës për sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat realizohet veprimtaria e subjektit.

Përgjegjësitë e Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit:

Objektivi ynë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe mbi përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare të institucionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.

Gjithashtu ne krijojmë një ide fillestare mbi kontrollin e brendshëm në mënyrë që të planifikojmë procedurat e auditimit që i përshtaten situatës aktuale.

Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm, që është identifikuar gjatë auditimit.

Audituesit identifikojnë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe përshkruhen në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë audituesit mendojnë që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Në vitin 2016 ish ZQRPP ka iniciuar një projekt me objekt “Përmirësimi/përditësimi, regjistrimi fillestar dhe dixhitalizimi i të dhënave të pasurive të

paluajtshme”. Referuar Vendimit të Bordit Drejtues të ish ZQRPP nr. 6, datë 06.07.2016, ky projekt synon të ofrojë akses për një informacion të përmirësuar/përditësuar mbi të drejtat e pasurive të paluajtshme në 181 ZK, si dhe regjistrimin fillestar në 22 ZK. Sipas analizës financiare të miratuar nga Bordi Drejtues rezulton se projekti do të shtrihet në një afat kohor prej 3 vitesh (2016-2018) dhe do të ketë një kosto totale prej 2,216,211,121 lekë. Për realizimin e këtij projekti, me vendimin e sipër përmendur Bordi Drejtues ka miratuar edhe nënshkrimin e kontratave të përkohshme për punësimin e 382 punonjësve për këtë qëllim. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezulton se edhe pas përfundimit të afatit të projektit, pra pas vitit 2018, ky projekt nuk ka përfunduar dhe me Vendimin nr. 8, datë 20/12/2018 dhe Vendimin nr. 22, datë 21/12/2020, Bordi Drejtues ka vijuar të miratojë numrin prej 382 punonjësish me kontratë të përkohshme për vijimin e projektit. Mos përfundimi i projektit brenda afateve të miratuara, (brenda vitit 2018) dhe shtrirja e tij në kohë edhe për 3 vite të tjera (deri në vitin 2021 momenti i auditimit), ka bërë që buxheti i ASHK të ngarkohet me kosto të shtuara për vitet 2019-2021 (*Trajtuar më hollësisht në faqet 30-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1 Rekomandimi: Agjencia Shtetërore e Kadastrës të analizojë arsyet për mos përfundimin në kohë të projektit, si dhe të ri vlerësojë edhe njëherë nevojat dhe numrin e saktë të punonjësve të nevojshëm dhe të marrë masa për planifikimin e saktë të afateve për përfundimin e tij, në mënyrë që të evitohen kostot për paga punonjësish duke zgjatur këtë projekt në kohë.

Shtator 2021.

2. Gjetje nga auditimi Nga auditimi konstatohet: Me VKM nr. 708, datë 21/11/2018 është miratuar regjistrimi dhe kalimi në përgjegjësi administrimi të Ministrisë përgjegjëse për Turizmin i disa pronave të paluajtshme shtetërore në vijën bregdetare Vlorë-Sarandë. Për këtë qëllim, me Vendim të Bordit Drejtues të ASHK nr. 5, datë 16/05/2019 është miratuar regjistrimi fillestar për zonat kadastrale të përcaktuara në VKM e sipër përmendur. Në vijim, me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të ASHK nr. 1355, datë 12/05/2020 ka filluar procesi i regjistrimit fillestar për 8 zonat kadastrale të vijës bregdetare Vlorë-Sarandë. Referuar pikës 3 të këtij urdhri, ky proces do të kryhet nga Projekti “Përmirësim/përditësim dhe regjistrim fillestar”. Në zbatim të këtij urdhri, punonjësit me kontratë janë angazhuar njëkohësisht për të dy proceset e regjistrimit, pa përfunduar më parë plotësisht projektin e iniciuar që në vitin 2016. Krahas këtij konstatimi, vihet re se në asnjë rast ASHK nuk ka punësuar numrin e plotë të punonjësve të nevojshëm sipas miratimit prej 382 punonjës, por ka punuar mesatarisht me rreth 60% të punonjësve të nevojshëm (*Trajtuar më hollësisht në faqet 30-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1. Rekomandimi: Agjencia Shtetërore e Kadastrës të marrë masa për analizimin e numrit të punonjësve të nevojshëm veçmas për secilin nga projektet e regjistrimit që ka në proces dhe sipas nevojës të përcaktojë numrin e saktë të punonjësve për secilin prej projekteve me qëllim finalizimin sa më shpejt të dy projekteve të nisura, duke përcaktuar edhe prioritetet mes dy regjistrimeve që ka në proces.

Shtator 2021.

3. Gjetje nga auditimi: Nga analiza e strukturës së institucionit dhe punonjësve me kontratë të ASHK-së konstatohet se, për periudhën objekt auditimi për muajt e zgjedhur nuk ka tejkalim të numrit të punonjësve si të strukturës miratuar me VKM nr. 84, datë 02.05.2019, ashtu dhe ata me kontratë të përkohshme miratuar me Vendim të Bordit Drejtues nr. 8, datë 20.12.2018, por shqetësues mbetet fakti i numrit shumë të lartë të punonjësve me kontratë për një periudhë të pacaktuar, krahasuara me ata në strukturë. Konkretisht, përmbushja e strukturës së miratuar gjatë muajve të përzgjedhur paraqitet si vijon:

Për muajin Gusht 2019 kanë rezultuar 67 punonjës më pak se struktura e miratuar, ndërkohë sa i takon punonjësve me kontratë kanë rezultuar më pak 145 punonjës; Për muajin Nëntor 2019 kanë rezultuar 67 punonjës më pak se struktura e miratuar, ndërkohë sa i takon punonjësve me kontratë

kanë rezultuar më pak përkatësisht 151 punonjës; Për muajin Shkurt 2020 kanë rezultuar 14 punonjës më pak se struktura e miratuar, ndërkohë sa i takon punonjësve me kontratë kanë rezultuar më pak përkatësisht 176 punonjës; Për muajin Prill 2020 kanë rezultuar 16 punonjës më pak se struktura e miratuar, ndërkohë sa i takon punonjësve me kontratë kanë rezultuar më pak përkatësisht 177 punonjës; Për muajin Korrik 2020 kanë rezultuar 17 punonjës më pak se struktura e miratuar, ndërkohë sa i takon punonjësve me kontratë kanë rezultuar më pak përkatësisht 178 punonjës (*Trajtuar më hollësisht në faqet 35-41 të Projektraportit të Auditimit*).

3.1. Rekomandimi: Agjencia Shtetërore e Kadastrës të marrë masa për të plotësuar në kohë vendet vakante në strukturë, si dhe të marrë në studim nevojat që ka për të planifikuar më saktë numrin e punonjësve me kontratë, duke përcaktuar edhe afate kohore në lidhje me kontratave.

Shtator 2021.

4. Gjetje nga auditimi: Përmbledhëset e listë pagesës janë të nënshkruara nga Përgjegjësja e Sektorit të Financës dhe Specialistja e Sektorit të Financës, Drejtori i Drejtorisë Ekonomike dhe Drejtori i Përgjithshëm i ASHK-së, por jo në çdo rast edhe nga Drejtori i Burimeve Njerëzore. Listë-pagesat janë të shoqëruara me listë prezencat sipas Drejtorive, të cilat janë të firmosura në çdo rast nga eprorët direkt për çdo drejtori (*Trajtuar më hollësisht në faqet 35-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1. Rekomandimi: Njësia e Financës, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve në ASHK, të marrë masa që në vijimësi të gjithë listë-pagesat të jenë të nënshkruara nga personat e përcaktuar sipas kërkesave të legjislacionit.

Menjëherë dhe në vazhdimësi.

5. Gjetje nga auditimi: Për Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK në periudhën objekt auditimi janë likuiduar detyrimet në vlerën totale prej 2,938,704 lekë, për 3 raste Vendimesh Gjyqësore të konkluduara në dëm të ASHK për largimet nga puna të punonjësve (*Trajtuar më hollësisht në faqet 41-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm ASHK të marrë masa për argumentimin e saktë dhe të mbështetur në bazën ligjore përkatëse për rastet e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës me punonjësit, në mënyrë që të evitohen efektet financiare negative në buxhet si pasojë e humbjes së seancave gjyqësore.

Në vazhdimësi.

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Pasqyrave Financiare të Aparatit të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Formatit 1 “Pasqyra e Pozicionit Financiar”, rezultoi se Llogaria 210 “Toka, Troje, Terrene” paraqitet në bilanc në vlerën 0 lekë për gjithë periudhën, ndërkohë që në certifikatën e pronësisë 186470, datë 13.03.2019 në Zonën Kadastrale nr. 8330, me NR Pasurie 8/114 në pronësi të ish ZQRPP rezulton Truall me sipërfaqe 7,500 m² dhe ndërtesë me sipërfaqe 2500 m², pra në pasqyrat financiare të institucionit nuk është regjistruar vlera e truallit. Kjo çështje për grupin e auditimit është konsideruar materiale, pasi, bazuar në VKM nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e vlerës së hartës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, (Harta sipas FZ nr.14, viti 2016, faqe 961) referuar vlerës së pasurisë së paluajtshme të llojit tokë truall për qytetin e Tiranës, (referuar çmimeve të vitit 2014), zona kadastrale nr. 8330, përcaktohet me çmimin prej 34,068 lekë/m², pra vlera e truallit që duhet të evidentohet në aktivet është më së paku 85,170,000 lekë(2500 m²* 34,068 lekë) (*Trajtuar më hollësisht në faqet 41-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1. Rekomandimi: Nga ASHK, Sektori i Financës të merren masat për të saktësuar vlerën e aktiveve afatgjata jo materiale “toka troje terren”, kontabilizuar dhe paraqitur në pasqyrat financiare vlerën e drejtë të Aktiveve Afatgjata Jo Materiale;

Nga Sektori i Financës të merren masat duke kryer veprimet përkatëse për evidentimin me evidenca kontabël në vijimësi dhe pasqyrimin e tyre në pasqyrat financiare/formatet përkatëse për vitin 2020.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Në Pasqyrat Financiare të vitit 2019 “Llogaria 212” paraqitet në shumën 133,289,805 lekë, e cila përfaqëson shpenzimet e kryera në vitin 2005 nga financuesi i rikonstruksionit të ZQRPP dhe ZVRPP Tiranë (Projekti i Shërbimeve Bujqësore –ASP Tiranë) në vlerën 97,172,310 lekë, si dhe vlera e rikonstruksioneve në vitet 2006-2018, të reflektuara këto në regjistrin e aktiveve të institucionit, për ish godinën e ZRPP me 6 kate, që sipas VKM nr. 411, datë 27.10.2014 tre kate me sipërfaqe 2500 m² i kanë kaluar në administrim të ish ZQRPP dhe ish ZVRPP Tiranë, e cila aktualisht në vitin 2020 është në pronësi të ASHK.

Në Kartelën e Pasurisë lëshuar më datë 13.03.2019, në Seksionin E, nga Regjistruesi është bërë shënimi “ndërtime të paligjshme”, ndërsa në Hartën Treguese të Regjistrimit me indeks TR-L-9 lëshuar po më datë 13.03.2019 në Pasurinë NR 8/114 ndodhen dhe dy ndërtesa të tjera, por nga ASHK nuk është ndërmarrë asnjë veprim për sistemimin e pronës (*Trajtuar më hollësisht në faqet 41-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7.1. Rekomandimi: ASHK të marrë masa në përputhje me legjislacionin në fuqi për saktësimin dhe rregullshmërinë e dokumentacionit për dy ndërtimet e paligjshme në pronën e saj, si dhe kryerjen e veprimeve të sistemimit në kartelën e pasurisë.

Në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi shpenzimet e kryera për udhëtim e dieta rezultoi se, urdhër shpenzimet e punonjësve janë autorizuar me shkrim nga titullari i institucionit, por në disa raste faturat tatimore nuk janë nënshkruar nga punonjësi udhëtues dhe nuk ishin të shoqëruara me relacion apo raportime për objektivat e shërbimit, veprime jo në përputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, KREU 3, pika 36 (*Trajtuar më hollësisht në faqet 41-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8.1. Rekomandimi: Nga ana ASHK, Sektori i Financës, të merren masat që urdhër shpenzimet për likuidimin e shërbimeve për udhëtim e dieta të shoqërohen me faturat tatimore të nënshkruara nga nëpunësi udhëtues dhe një raport i hollësishëm për objektin dhe qëllimin e shërbimit.

Në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi për kryerjen e shpenzimeve për karburant, u konstatua se në të gjitha raste fletë daljet e magazinës së karburantit, nënshkruhen nga personi i cili ka tërhequr karburantin, si dhe procedohet edhe në bazë të një përmbledhëse të konsumit, por kishte raste ku fletë udhëtimet ishin të pa nënshkruar nga punonjësit që kanë kryer lëvizjet. Konstatohen parregullsi në plotësimin e fletë-udhëtimeve, pasi jo çdo rast janë plotësuar të gjitha lëvizjet me destinacionet përkatëse, pa shënuar distancat në kilometra të tyre, veprime këto në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, KREU 3, pika 36 (*Trajtuar më hollësisht në faqet 41-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

9.1. Rekomandimi: Nga ASHK, Sektori i Analizës dhe Mbështetjes të merren masat që fletë udhëtimet e harxhimit të karburantit të plotësohen me të gjitha ekstremitetet e tyre, në fund të çdo muaji të nënshkruhen nga personat udhëtues të cilët kanë përdorur kartën e tërheqjes së karburantit, duke i bashkëlidhur kuponët e nxjerrë nga kasa fiskale.

Në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi për shpenzimet telefonike të kryera për vitet 2019-2020 rezultoi se janë përfutues të shpenzimeve për telefona celular 5 drejtuesit e institucionit, ku referuar faturave mujore nuk kanë kaluar limitet e përcaktuara sipas kërkesave të VKM nr. 864, datë 23.07.2010 “Për pajisjen me telefon celular të personave juridikë publikë”, por nga titullari i institucionit nuk ka urdhër të veçantë për miratimin e përfutuesve të rimbursimit të shpenzimeve për telefonat celular, veprime këto në kundërshtim me dispozitën nënligjore të sipërcituar (*Trajtuar më hollësisht në faqet 41-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

10.1. Rekomandimi: ASHK Drejtoria e Financës dhe Burimeve Njerëzore të marrin masa të hartojnë urdhrat për përfituesit dhe mënyrën e përdorimit të telefonave celularë.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i shpenzimeve operative, shpenzime për udhëtim e dieta për vitin 2020, konstatohet se u janë mbuluar punonjësve të institucionit shpenzime udhëtimi e dieta **për ditë të shtuna**, konkretisht: janë paguar 9 punonjës stafi, në shumën 64,500 lekë, si dhe dieta të projektit “Regjistrimi dhe përditësimi fillestar” për zonat kadastrale në bregdetin e jugut, në 27 raste, në shumën 1,465,000 lekë, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjëset që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit”, i ndryshuar, dhe me kontratat individuale të punës, në të cilat përcaktohen kohëzgjatja në punë e çdo punonjësi me 40 orë në javë.

Shpenzimet e mësipërme **në shumën 1,529,500 lekë**, edhe pse kanë marrë miratimin e titullarit konsiderohen si shpenzime pa efektivitet për institucionin, pasi në këto raste, nëse është e nevojshme kryerja e shërbimeve ditë të shtuna duhen miratuar shpenzimet nga Këshilli Drejtues, pasi është organi vendimmarrës për miratimin rregullave për përdorimin e fondeve buxhetore (Trajtuar më hollësisht në faqet 41-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Burimeve Njerëzore të marrin masa, që të eliminojnë kryerjen dhe pagesën e shërbimeve në ditët e shtuna në respektim dhe të kontratave individuale të punës me punonjësit. Në rastet specifike, të paraqesin dhe të miratojnë në Bordin Drejtues afatet e kryerjes së këtyre shpenzimeve dhe fondet përkatëse.

Në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare të Aparatit të ASHK, Formati 3 “Pasqyra e Flukseve Monetare (cash flow)”, referuar dhe nxjerrjes së llogarive bankare në fund të vitit 2020, rezultoi se institucioni ka në llogaritë e tij rrjedhëse të ardhura të pa përdorura në shumën **1,455,667,619 lekë**. Nga sa më sipër rezulton se, ish ZQRPP sot ASHK mban në llogaritë e saj mjete të lira në shuma të konsiderueshme, të cilat nëse do të investoheshin në depozita apo bono thesari në Bankën e Shqipërisë më së paku, do të krijon të ardhura për institucionin, duke përdorur me efektivitet fondet e saj, por dhe për të përballuar kostot e shpenzimeve për marrjen me qira të ambienteve për ushtrimin e veprimtarisë së disa prej drejtorive (Trajtuar më hollësisht në faqet 61-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1.Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i ASHK, të propozojë për miratim në Bordin Drejtues investimin e fondeve të disponueshme dhe në gjendje të lirë në llogaritë bankare, në depozita apo bono thesari në Bankën e Shqipërisë, me qëllim përdorimin me efektivitet të fondeve buxhetore dhe krijimin e të ardhurave për institucionin për përballimin e kostove të marrjes me qira të ambienteve dhe për ushtrimin e veprimtarisë së saj.

Në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratave të lidhura ndërmjet AKSHI-it dhe Operatorëve Ekonomikë, për sistemet IT, zbatimi i të cilave monitorohet dhe likuidohet nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës konstatohet se, në këto kontrata nuk janë reflektuar ende ndryshimet e parashikuara në pikën 18 dhe 19, dhe 24 të VKM nr. 673, datë 22.11.2017, “Për Organizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, i ndryshuar.

-Gjithashtu, nuk janë dokumentuar kontrollet (monitorimet), gjatë zbatimit dhe në përfundim të kontratave, Autoriteti Kontraktor (të ngarkuarit me ndjekjen e kontratës), nuk kanë përgatitur raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e shërbimit, në kundërshtim me pikën 3 të nenit 77 (Mbikëqyrja e Kontratës) të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet: “Për t’u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë, autoriteti kontraktor duhet të

monitorojë zbatimin e kontratës ose lëvrimet dhe në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara, zbaton penalitetet, e parashikuara në kontratë, apo detyrimet, në mbështetje të nenit 62, të LPP-së. Autoriteti kontraktor, gjatë kryerjes së kontroleve, mban procesverbal, me shkrim. Në përfundim të kontratës, autoriteti kontraktor përgatit një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës. Një kopje e këtij raporti i jepet edhe kontraktorit, me kërkesë të tij”.

-Nga ASHK është likuiduar subjekti “BNT” më datë 27.12.2019, në shumën 6,029,376 lekë, sipas faturës tatimore datë 11.04.2019 dhe akt-marrjes në dorëzim datë 11.04.2019, me objekt blerje servera databaze dhe stronga, për “Përmirësimin e Arkivës Dixhitale”, pra me 8 muaj vonesë nga marrja e shërbimit. Konstatohet se, nga Dega Financës nuk janë kryer kontabilizimet në momentin e lidhjes së kontratave shërbimeve të mirëmbajtjes së rrjeteve informatike, apo të lindjes së detyrimit dhe për vlerën e plotë të kontratave, por kontabilizimi është kryer në momentin e mbërritjes së faturave dhe kryerjes së pagesave, në kundërshtim me nenin 52 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në faqet 61-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

13.1.Rekomandim: Titullari i ASHK të përcaktojë personat përgjegjës për ndjekjen e kontratave (monitorimet), si dhe të përgatiten raportet përmbledhëse për korrektësinë dhe cilësinë e shërbimit. -Drejtoria e Financës në ASHK të kryejë veprimet e kontabilizimit për vlerë të plotë të kontratave për mallra e shërbime në momentin që nënshkruhen kontratat midis operatorit ekonomik dhe Institucionit, apo kur lind një detyrim.

Në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i shpenzimeve për marrje ambientesh me qira, konstatohet se, institucioni për vitet 2019-2020 ka lidhur *gjithsej 4 kontrata, në shumën 13,440,636 lekë*. Ambientet janë marrë me qira për ushtrimin e aktivitetit të disa prej drejtorive të ASHK, pas bashkimit të dy institucioneve (ZRPP dhe ALUIZNI), *të pa parashikuar dhe miratuar në buxhetet vjetore dhe pa kryer procedura tenderimi, si dhe pa miratimin nga Këshilli Drejtues për kryerjen e këtij shërbimi, ndërsa në një rast lidhja e kontratës për marrjen e ambienteve me qira nga titullari është për 5 vite, pra në të gjitha rastet janë tejkaluar kompetencat e titullarit. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me nenet 8 dhe 9 të ligjit nr. 111/2018 “Për Kadastrën”, i ndryshuar dhe me kërkesat e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, duke sjellë *përdorim pa efektivitet të fondeve në vlerë 13,441 mijë lekë (Trajtuar më hollësisht në faqet 61-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.*

14.1.Rekomandimi: ASHK të marrë masa për parashikimin në buxhetet vjetore të shpenzimeve për marrjen e ambienteve me qira, duke marrë dhe miratimin rast pas rasti të Këshillit Drejtues. Meqenëse ASHK disponon fonde të lira të konsiderueshme të shohë me përparësi mundësinë e rikonstruksionit të godinës, të dëmtuar nga tërmeti i nëntorit 2019, me qëllim uljen e shpenzimeve të qirave marrjes.

Menjëherë e në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Në hartimin e planeve vjetorë të auditimit nga Drejtoria e Auditit të Brendshëm nuk janë parashikuar auditimi i rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme veprime në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” Neni 6 pika c, ç; Neni 12 pika d, si dhe me Manualin e Auditimit miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016. pika 4.1.13 “Ndjekja e rekomandimeve”. Në raportet e veprimtarisë vjetore nuk arsyetohet shkresërisht mos realizimi i planit të auditimit si dhe shmangiet nga ky plan veprime në kundërshtim me ligjin 114/2015 Neni 14 “Përgjegjësitë e drejtuesit të njësisë së auditimit të brendshëm” si dhe me Manualin e Auditimit (*Trajtuar më hollësisht në faqet 91-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

15.1. Rekomandim: Nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm të merren masa që; në hartimin e planeve vjetorë të auditimit të parashikohen auditimi i rekomandimeve të lëna në auditimet e

mëparshme; në raportet e veprimtarisë vjetore të arsyetohet shkresërisht mos realizimi i planit të auditimit si dhe shmangiet nga ky plan.

Në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Deri në momentin e auditimit, në zbatim të Ligjit 111/2018 “Për Kadastrën” janë miratuar 13 akte nënligjore, nga 18 të parashikuara nga ky ligj, 2 prej tyre janë dërguar për shqyrtim në KM më datë 11.12.2020 dhe deri në periudhën objekt auditimi nuk janë miratuar, ndërsa 3 të tjerë janë draftuar dhe do të përcillen për shqyrtim sipas planit të përgjithshëm analitik të projekt akteve për vitin 2021. Nga verifikimi rezulton që 5 akte janë hartuar dhe dërguar/do të dërgohen me tepër vonesë dhe jashtë afatit të përcaktuar dhe konkretisht:

- VKM "Për rregullat e hollësishme për përdorimin, administrimin dhe ruajtjen e bazës së të dhënave mbi pasuritë e paluajtshme";
- VKM "Për rregullat dhe procedurat për ushtrimin e së drejtës nga personat juridikë/fizikë vendas apo të huaj për të pasur akses në sistemin elektronik";
- VKM "Për rregullat për procedurën e trajtimit të kërkesave nga ASHK";
- VKM "Për rregullat e hollësishme për mënyrat dhe mjetet teknike-hartografike për realizimin e përmirësimit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme";

VKM "Për elementet formale të akteve noteriale, vendimeve gjyqësore apo akteve administrative që kontrollohen për efekt regjistrimi" (*Trajtuar më hollësisht në faqet 99-104 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

16.1.Rekomandimi: Agjencia Shtetërore e Kadastrës të marrë masa që të nxisë shqyrtimin sa më parë të akteve nënligjore të dërguara tashmë dhe atyre që do të dërgohen në vijim në zbatim të Ligjit 111/2018, në mënyrë që të shmangen pasaktësitë dhe keq interpretimet e ligjit në fjalë si pasojë e mungesës së akteve nënligjore plotësuese.

Menjëherë.

17. Gjetje nga auditimi: Deri në momentin e auditimit, në zbatim të Ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” janë miratuar vetëm 3 akte nënligjore, nga 19 të parashikuara, 9 prej tyre janë dërguar për shqyrtim në KM gjatë muajit dhjetor 2020 dhe ende nuk janë miratuar, ndërsa 7 të tjerë janë draftuar dhe do të përcillen për shqyrtim sipas planit të përgjithshëm analitik të projekt akteve për vitin 2021. Nga verifikimi rezulton që janë 7 aktet ende të pa përcjella për shqyrtim janë jashtë afatit të sipër cituar dhe konkretisht:

- VKM “Për rregullat e hollësishme për kalimin e të drejtës së pronësisë dhe regjistrimin e pasurisë së legalizuar, pagesën, çmimin favorizues, kategoritë e subjekteve që përfitojnë falje, si dhe përqindjet e përdorimit të bonove të privatizimit”;
- VKM "Për kushtet, kriteret dhe procedurat e përfitimit të poseduesve të ndërtimeve pa leje me funksion banimi që kanë pësuar dëme si pasojë e fatkeqësisë natyrore";
- VKM “Për procedurat e hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullat për bashkëpunimin mes institucioneve”;
- VKM “Për rregullat e hollësishme për hartimin e planit të rievimit për zonat e stimuluar”;
- VKM "Për rregullat e hollësishme të bashkërendimit të punës ndërmjet ASHK-së dhe ATP-së";
- VKM “Për procedurat e hollësishme që zbatohen për kalimin e pronësisë dhe modeli i aktit të kalimit të pronësisë të trojeve shtetërore në përdorim”;
- VKM “Për vlerat e tarifave të shërbimit, pagesave, masat e penalteteve, si dhe për mënyrën e llogaritjes, mbledhjes dhe administrimit të tyre” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 99-104 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi: Agjencia Shtetërore e Kadastrës të marrë masa që të nxisë shqyrtimin sa më parë të akteve nënligjore të dërguara tashmë dhe atyre që do të dërgohen në vijim në zbatim të Ligjit

20/2020, në mënyrë që të shmangen pasaktësitë dhe keq interpretimet e ligjit në fjalë si pasojë e mungesës së akteve nënligjore plotësuese.

Menjëherë.

18. Gjetje nga auditimi: Nga Sektori i Kontrollit Tekniko Ligjor dhe Cilësisë së Shërbimit në kryerjen e kontrole pranë drejtorive dhe zyrave vendore, me tematikë për ankesat e qytetarëve në lidhje me vonesat në trajtimin e aplikimeve për shërbim kadastral, paligjshmëri në procedurat e ndjekura për legalizimin e ndërtimeve pa leje, si dhe regjistrim të pasurive në regjistrat e pasurive të paluajtshme, u konstatua se: Në 6 raste për një shkelje të konstatuar dhe të dokumentuar, janë marrë të dy masat si administrative, ashtu dhe disiplinore. Në dhënien e masave disiplinore së bashku me masat kundërvajtjet administrative është vepruar në kundërshtim me referencën ligjore të referuar në çdo shkelje, pikës 2, neni 64 të ligjit 111/2018 “Për Kadastrën” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 104-109 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

18.1. Rekomandim: Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës për shkeljet e konstatuara nga Sektori i Kontrollit Tekniko Ligjor dhe Cilësisë së Shërbimit, të ketë në konsideratë aplikimin e sanksioneve në përputhje me referencat ligjore të mos zbatuara duke mos aplikuar masa disiplinore së bashku me kundërvajtjet administrative kur dispozita e referuar pika 2, neni 64 të ligjit 111/2018 “Për Kadastrën” parashikon vetëm vendosjen e dënimit me gjobë.

Menjëherë.

19. Gjetje nga auditimi: Për periudhën Maj 2019 - 31/12/2020, Sektori i Marrëdhënieve me Publikun, Transparencës dhe Antikorrupsionit ka trajtuar 1111 praktika nga 1921 praktika të ardhura gjithsej ose 57.8 % të praktikave të administruara. Referuar të dhënave të administruara nga ky sektor, vihet re se niveli i trajtimit të kërkesave/ankesave nuk është ai i duhur ku për një periudhë 1.5 vjeçare u jepet zgjidhje mesatarisht 52% të tyre. Nga ku u konstatua se:

-nuk ka një dokumentacion për mos trajtimin e mbi 40 % të ankesave apo një delegim të tyre sipas kompetencave ligjore, personave përgjegjës

-në ankesat me përgjigje në asnjë rast nuk është zbatuar afati i përgjigjes në përputhje e zbatim të “Kodit të Procedurave Administrative” si dhe nuk ka dokumentacion për të justifikuar zgjatjen kohore të përgjigjeve mbi arsyetimin se; çështjeve që duhet të kryhet hetim administrativ u nevojitet kohe me e madhe për përgjigje si dhe për shkak të situatës të krijuar nga pandemia,

-për çështjet e ankimuar me problematika që duhet të zgjidhen nga Drejtorive Vendore sipas detyrimeve ligjore në asnjë rast nuk ka një analizë apo nxjerrje përgjegjësie për Drejtoritë Vendore apo dhe për persona përgjegjës (*Trajtuar më hollësisht në faqet 109-116 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

19.1 Rekomandim: Drejtoria Juridike në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës si eprorë të Sektorit të Marrëdhënieve me Publikun, Transparencës dhe Antikorrupsionit të nxjerrë përgjegjësitë për mos trajtimin e mbi 40 % të ankesave të ardhura, për vonesat në përgjigje përtej afateve ligjore të përcaktuara si dhe të marrë masa për nxjerrjen e përgjegjësive të Drejtorive Vendore e personave përgjegjës.

Menjëherë e në vijimësi.

B. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

Nga auditimi i kryer në drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës është konstatuar se për shërbimin e ruajtjes dhe i sigurisë fizike të ambienteve të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, në vitin 2019 konkretisht për periudhën 16.08.2018 deri 16.08.2019 është shpenzuar në shumën 2,915,926.45 lekë pa TVSH ose 3,499,111.74 lekë me TVSH”, e detajuar sipas muajve

vlehtë 242,993.87 lekë në muaj pa TVSH ose 291,592.64 lekë në muaj me TVSH. Ky shpenzim është kryer në përputhje e zbatim të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar pasi është tenderuar shërbimi dhe me Operatorin Ekonomik Fitues është lidhur kontrata e shërbimit në vlerat e cituara më sipër.

Për periudhën në vazhdim për të njëjtin shërbim pa tenderim është lidhur kontrata midis Agjencia Shtetërore e Kadastrës me nr. 12392, datë 16.08.2019 dhe Shoqëria “IG” me nr. 229, datë 16.08.2019, me objekt sipas nenit 2 të kontratës

“...kryerjen e shërbimit sipas specifikave të përfshira në Rregulloren e Brendshme të Sigurisë së Objektivit, në përputhje me termat e kushtet e kontratës.”

Dhe me çmimin dhe mënyrën e pagesës të përcaktuar në nenin 5 të kësaj kontratë:

“5.1 Subjekti do t’i paguajë Ofertuesit të Shërbimit, si kompensim për kryerjen e shërbimeve në përputhje me termat e vendosur sipas Udhëzimit të përbashkët nr. 407/1, datë 14.06.2019 të Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave. Vlera mujore e kësaj kontratë është 199,480 lekë me roje + 190,206 lekë me sisteme = 389,686 lekë pa TVSH”....

5.4 Tarifa e shërbimit është subjekt i pagesës së TVSH. Tarifa mujore 467,623.2 lekë me TVSH”.

Kohëzgjatja dhe përfundimi i kontratës i përcaktuar në nenin 8 të saj është 16.08.2019 – 31.12.2019. Kontratë me Shoqërinë “IG” është lidhur në zbatim të pikës 10 të VKM nr. 177, datë 04.04.2019 “Për krijimin e shoqërisë “IG” sh.a. dhe për përcaktimin e autoritetit publik, që përfaqëson Shtetin si pronar të aksioneve të kësaj shoqërie” ku përcaktohet:

“10. Të gjitha institucionet dhe subjektet publike, të cilat kanë në administrim objekte shtetërore, ruajtja dhe sigurimi i të cilave duhet të realizohet nga shërbime të specializuara për këtë qëllim, i drejtohen, me kërkesë, kësaj shoqërie, për të përfutur shërbimin e ruajtjes dhe të sigurisë fizike.”

Vlera e kontratës është përcaktuar në zbatim të Udhëzimit të përbashkët nr. 407/1, datë 14.06.2019 të Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave. “Për mënyrën e përllogaritjes së tarifave të shërbimeve specifike, që u ofrohen subjekteve publike, nga shoqëria “IG”

Për sa më lart për të njëjtin shërbim të ruajtjes dhe i sigurisë fizike të ambienteve të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, periudhën 1 vjeçare 01.01.2020 deri 31.12.2020 janë shpenzuar më shumë në vlerë 1,794,505.55 lekë pa TVSH (ose 2,153,406.66 lekë me TVSH) se shuma totale prej 2,915,926.45 lekë pa TVSH (ose 3,499,111.74 lekë me TVSH) e shpenzuar në periudhën 1 vjeçare 16.08.2018 deri 16.08.2019

Mos përdorimin i fondeve me ekonomicitet e efikasitet dhe krijimi i diferencave për të njëjtin shërbim ka ardhur nga mos kryerja e tenderimit të shërbimit të ruajtjes dhe i sigurisë fizike të ambienteve të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, veprime këto në kundërshtim me nenin 1 e 2 të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet:

Neni 1: Objekti dhe qëllimi

1. Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga autoritetet kontraktore.

2. Qëllimi i këtij ligji është:

a) të rrisë eficientë dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore;

b) të sigurojë mirë përdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;

c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;

dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Neni 2

Parimet e përzgjedhjes

Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me këto parime të përgjithshme:

a) mos diskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve;

b) transparencë në procedurat e prokurimit;

c) barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 77-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim: Ministria e Financave të rishikojë vlerat për shërbimin e përcaktuar në Udhëzimin e përbashkët nr. 407/1, datë 14.06.2019 të Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave. “Për mënyrën e përlogaritjes së tarifave të shërbimeve specifike, që u ofrohen subjekteve publike, nga shoqëria “IG”, duke krijuar mundësinë që shoqëria “IG” të marrë pjesë në prokurimin e këtij shërbimi si i barabartë dhe konkurrese me subjektet e tjera.

Deri më 30.09.2021

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në Kreu IV, neni 11 germa “d” dhe “e” dhe nenit 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën”, të ndryshuar, si dhe në kontratën kolektive dhe individuale të punës, **Drejtori i Përgjithshëm**, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo punonjës sipas trajtimit në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe për personat përgjegjës të aplikojë marrjen e masave disiplinore nga “**Vërejtje**” deri në “**Vërejtje me paralajmërim**”.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit.

K R Y E T A R

Arben SHEHU